

Mbi reformën në trashëgiminë kulturore

Shkrim ne Gazeten Panorama date 3 korrik 2013

GJERGJ FRASHERI

Siç e kemi ngritur zërin disa herë në tre vjetët e fundit, mendojmë se është koha për të tërhequr vëmendjen edhe një herë, se menaxhimi i ruajtjes, mbrojtjes dhe shpëtimit të pasurisë arkeologjike dhe të monumenteve të kulturës në Republikën tonë duhet të bëhet nën një komandë nga një dikaster i posaçëm. Masakra e pashembullt që po përjetojmë prej vitesh ndaj veprave të trashëgimisë kulturore, të pasurisë arkeologjike dhe të monumenteve të kulturës duhet të ndalohej menjëherë. U bënë gjithashtu vite që kemi propozuar reformën në trashëgiminë kulturore për ruajtjen, mbrojtjen dhe shpëtimin e veprave të vyera të kësaj Republike. Përmend këtu për referencë shkrimin tim të 22 marsit 2010, me titull “Trashëgimia Kombëtare, në duart e profesor Cekës?”, ku pata kritikuar modelin që këshilltari i mirënjohur i Kryeministrit pati propozuar atëherë për “reformën” e tij në trashëgiminë kulturore, për të cilën koha vërtetoi se ishte një orvatje negative e qëllimshme e një grupi nëpunësish të lartë të shtetit, duke shpërdoruar veprat e trashëgimisë për përfitime vetjake. Rrjedhimisht, dëmet, vjedhjet dhe grabitjet mbi monumentet e kulturës dhe pasurinë arkeologjike janë bërë sot kronikë e ditës. Ato skicohen dhe drejtohen nga institucionet shtetërore, që janë kthyer në konflikt me ligjin, në segmente private për përfitime financiare.

Dhjetëra shkrime të tjera kritike që pasuan në kërkim të reformimit të strukturave aktuale të ruajtjes, mbrojtjes dhe shpëtimit të monumenteve dhe pasurisë arkeologjike, ranë në vesh të shurdhër, ndërkohë që revanshi i dëmeve ndaj tyre vazhdoi. Modeli i zotit Ceka, i mbështetur edhe nga drejtori i Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK), mjerisht u vu në jetë “de facto” me mbështetjen e heshtur të Kryeministrit të vendit. Ka qenë një fatkeqësi historike, për të cilën jam përpjekur t’i tërheq vëmendjen edhe vetë udhëheqjes qeveritare, por pa sukses (disa nga shkrimet në shtypin e shkruar: “Krimet në trashëgimi, Ceka e Baçe lajnë duart si Ponc Pilati”, “Ceka-Baçe, dëshmi e dëmeve në ruajtjen e monumenteve”, “Ceka e Baçe kanë ushtruar presion”, “Kujdestaria e ‘zëdhënësit’ të Kryeministrit nuk i mbron monumentet” etj.). Gjatë këtyre tre vjetëve të fundit, u krye përpara syve tanë, jo vetëm dëmtimi i qëllimshëm antikombëtar i veprave historike të vendit tonë, por edhe shfrytëzimi pa skrupull i këtyre dëmeve në favor të përvetësimeve financiare private të grupimeve dhe individëve të veçantë, pa dyshim, në mesin e të cilëve ndodhej edhe vetë zoti Ceka dhe zoti Baçe. Nuk shpjegon kush përse luhet ende ky kriminalizim i veprave kombëtare.

Është për të ardhur keq që dikush vesh kostumin e profesionistit dhe merr nga qeveria kredi politike për të dëmtuar pasurinë kombëtare. Nuk i bën syri tërr për vite me radhë! Sikur të mos mjaftonte kjo, mësojmë së fundi me keqardhje se kështu Kryeministri, më datën 6 shkurt 2013, duke anashkaluar Kuvendin, ka firmosur një urdhër (nr. 7) për “miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit të Monumenteve të Kulturës ‘Gani Strazimir’ dhe të drejtorive rajonale të kulturës kombëtare”, në mbështetje të nenit 102 (pika 3) të Kushtetutës, të nenit 4 (pika 4) të ligjit nr. 8549, “Statusi i nëpunësit civil” dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. E ç’është kjo? Për t’i rritur fuqinë IMK-së? Marrim vesh se këtij instituti i janë shtuar drejtori qesharake, duke rritur organikën në Tiranë për punë kozmetike dhe duke reduktuar punonjësit në bazë që ruajnë monumentet. Në vend që të shmanget IMK-ja nga një përgjegjësi ligjore që nuk po e kryen

tashmë prej vitesh, siç është ruajtja, mbrojtja dhe shpëtimi i monumenteve, sepse është e zhveshur nga kompetenca dikasteriale për ta kryer këtë punë, i shtohet pesha burokratike me drejtorira humoristike, të cilat nuk kanë të bëjnë aspak me ruajtjen e monumenteve. Ligjërisht, IMK-ja është i vetmi institucion me këtë detyrë themelore në Republikë, por IMK-ja prej vitesh merret me çdo gjë; me tendera dhe projekte private, me ekspozita arkeologjike jashtë vendit etj; vetëm me ruajtjen e monumenteve nuk merret. Përse atëherë rritet ky institut, në vend që të zvogëlohet, të profilizohet për ruajtjen e monumenteve? Kujt i mbetet sot detyra ligjore për ruajtjen e monumenteve?

Më 26 gusht 2011 i pata propozuar ministrit të Kulturës një program se si duhet të ristrukturoheshin organizmat ministrorë dhe ato vartëse institucionale, që shpëtimi i monumenteve dhe pasurisë arkeologjike të kryhej në vendin tonë sipas Marrëveshjeve Europiane që qeveria kishte firmosur prej vitit 2008. Asnjëherë nuk mora përgjigje. Thelbin e programit të propozuar po e paraqes në mënyrë skematike më poshtë, duke qenë optimist se qeveria që do të vijë, do të tregojë një kujdes më të madh dhe profesional për trashëgiminë kulturore.

Domosdoshmëria dhe qëllimi i drejtpërdrejtë i reformës orientohet në ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë arkeologjike dhe të monumenteve të kulturës. Kjo është detyra themelore e saj. Përfshirja e këtyre veprave në turizmin kulturor është një proces i veçantë. E kam fjalën, një monument duhet të ruhet dhe të mbrohet në çdo kohë, pavarësisht nëse ai vihet në dispozicion apo pajiset me kushtet për t'u vizituar nga turisti. Natyrisht edhe kjo është detyrë e nevojshme, por kujdesi për ruajtjen dhe mbrojtjen e monumentit nuk varet nëse vjen turisti për ta parë atë, apo nuk vjen. Po nuk erdhi sot, do vijë pa dyshim nesër. Monumenti duhet të ruhet në çdo kohë. Pa ruajtje nuk ka turizëm. Pikërisht në këtë pikë, puna me trashëgimisë kulturore në vendin tonë në vitet e fundit ka hyrë në një rrugë pa perspektivë. Përveç dëmeve të mëdha që ka pësuar, është vënë në rrezik edhe kuptimi i saj për identitetin tonë kombëtar. Pasuria arkeologjike dhe monumentet nuk kuptohen si dokumente kombëtare, prandaj ato po zhvlerësohen qoftë edhe si objekte turistike. Ashtu siç premtojnë forcat e reja politike që po vinë në udhëheqje të vendit, kanë rastin për të hapur një perspektivë të re në vlerësimin e trashëgimisë kulturore, e cila është për vendin tonë një burim industrie jetike, shpirtërore dhe materiale; gjithashtu për të siguruar planifikimin dhe zhvillimin e saj, sipas standardeve europiane – në njërën anë, për reformimin e institucioneve shkencore shtetërore ekzistuese të kësaj sfere, të cilat e kanë humbur bazën ligjore dhe sociale të kohës, kur u krijuan dhe kanë dalë jashtë efikasitetit për mbrojtjen dhe shpëtimin e trashëgimisë kulturore; në anën tjetër, për ndërtimin e strukturave ekzekutive shtetërore të afta për marrjen e vendimeve efikase dhe kontrollin e aktivitetit privat në fushën e arkeologjisë, monumenteve dhe turizmit, në përputhje me kushtet aktuale politike, ekonomike dhe mbi të gjitha, të mendësisë dhe problemeve sociale të sotme të qytetarit dhe të investitorit të këtij vendi.

Koncepti i reformës në organizimin strukturor qeverisës të trashëgimisë kulturore që propozojmë përfshin mbrojtjen e kulturës së nëntokës (arkeologjia e shpëtimin) dhe mbrojtjen e asaj të mbitokës (shpëtimi i monumenteve) nën një dikaster të posaçëm, ndoshta një komitet për arkeologjinë dhe monumentet e kulturës. Megjithatë flitet për thesaret dhe dokumentet e historisë së kombit, të cilat aktualisht ndodhen në rrezik historik nga vagabondimi i pronës private në Shqipëri, mendoj që ky komitet të ketë varësi direkte nga Kryeministri. Kjo do të ndihmojë një detyrë tjetër bashkëkohore kombëtare – bashkërendimin e drejtpërdrejtë të tij me strukturat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore edhe në hapësirat e tjera të trojeve shqiptare.

Kryetari dhe nënkryetari i komitetit do të kenë në varësinë e tyre në dy drejtori të veçanta; Drejtorinë e

Përgjithshme të Shpëtimit të Arkeologjisë (sot ekziston si Agjencia e Shpëtimit Arkeologjik – ASHA pranë MTKRS) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shpëtimit të Monumenteve (sot përpiqet ta luajë këtë rol Instituti i Monumenteve të Kulturës). Nën drejtimin e kryetarit të komitetit vepron edhe Këshilli Kombëtar Vendimmarrës për Arkeologjinë dhe Monumentet. Të dyja drejtoritë e përgjithshme të shpëtimit do të kenë drejtoritë rajonale të tyre, njëra për mbrojtjen dhe shpëtimin e arkeologjisë, tjetra për mbrojtjen dhe shpëtimin e monumenteve. Detyrat e secilës prej tyre kanë specifikë të veçantë, por administrativisht do të jenë nën një ndërtesë në çdo rreth për shkak të bashkërendimit tekniko-organizativ dhe ligjor ndaj dëmtimeve intensive të sferës private në veprat e trashëgimisë. Nën drejtimin e nënkryetarit do të jenë drejtoria e përbashkët juridike për arkeologjinë dhe monumentet, arkiva të përbashkët për të dy drejtoritë e përgjithshme, laboratoritë gjetjeve arkeologjike (metalit, drurit, paleobotanikës, C14, kockës, etj.) dhe punishtja dhe laboratoritë restaurimit të veprave të artit.

**

Komiteti për Arkeologjinë dhe Monumentet e Kulturës mban përgjegjësi për të gjitha nevojat që paraqiten për shpëtimin e vlerave të tyre që kërcënohen nga aktiviteti ndërtimor, nga ndërtimet pa leje, ashtu edhe nga kërkesat e investitorëve për ndërtime legale, nga vjedhjet dhe grabitjet, nga dëmtimet statike apo të pjesëve artistike në një kishë, xhami etj. Ky lloj kontrolli dhe koordinimi i vazhdueshëm ka ngarkesë të madhe juridike dhe nuk është punë institucionesh shkencore. Për shembull, Instituti Arkeologjik nuk merret me veprimtari shpëtuese dhe nuk kryen gjurmime arkeologjike shpëtimi. Ai merret me kërkime shkencore dhe me gjurmime shkencore arkeologjike, më të shumtën e rasteve për qëllime pedagogjike. Ka një ndryshim të madh midis këtyre dy veprimtarive dhe përgjegjësisë. Ato janë të ndara dhe nuk kanë të bëjnë me njëra-tjetrën, pavarësisht se kanë të njëjtën objekt -arkeologjinë. Është si ndryshimi dhe afria profesionale e inxhinierit të ndërtimit që ndërton digën e hidrocentralit dhe pedagogut inxhinier ndërtimi që u mëson studentëve në universitet se si ndërtohet diga e hidrocentralit. Koha ka treguar se edhe Instituti i Monumenteve të Kulturës nuk ka më efektivitet në parandalimin e dëmtimeve dhe shpëtimin e monumenteve në terren. Sot është bërë emergjente pikërisht pjesa e veprimtarisë shpëtimtare të monumenteve në terren, menaxhimi administrativo-ligjor për ruajtjen dhe shpëtimin e tyre, prandaj kjo pjesë e veprimtarisë së këtij instituti duhet të ndahet nga pjesa tjetër e veprimtarisë thjesht studimore-shkencore për historinë e monumenteve. Kjo e fundit, që merret me studimin e historisë së arkitekturës, të artit, të studimit dhe ruajtjes së monumenteve për qëllime shkencore e pedagogjike, e ka vendin në Qendrën e Studimeve Albanologjike apo në Universitetin e Tiranës. Ndërsa pjesa e veprimtarisë shpëtuese duhet të reformohet dhe t'i përshtatet strukturës së komitetit dhe t'i atashohet Drejtorisë së Përgjithshme të Shpëtimit të Monumenteve. Struktura e propozuar mbështetet edhe në modelin e disa vendeve perëndimore të qeverisjes së trashëgimisë kulturore. Ajo është ngritur me dy drejtori nën një ombrellë, që të sigurojë qartësinë e bashkëveprimit arkeolog-restaurator në praktikë për shpëtimin e vlerave të nëntokës dhe të mbitokës. Një qëllim final i këtij organizimi është që të parandalohet çdo gjurmim arkeologjik, i cili nuk siguron juridikisht dhe financiarisht shpëtimin e substancës arkeologjike pas gjurmimit. Deri sot është ngritur në vendin tonë sipas modelit evropian vetëm njëri krah – Agjencia e Shpëtimit Arkeologjik (ASHA). Tehu kryesor i reformës sot duhet të jetë ndërtimi i krahut tjetër – Drejtoria e Shpëtimit të Monumenteve, që të plotësohet Komiteti i Trashëgimisë Kulturore. Nuk duhet harruar, se aq sa e rëndësishme është përshtatja e konceptit të reformës, po aq janë edhe aktorët që do ta drejtojnë atë. Puna me pasurinë

arkeologjike dhe me monumentet e kulturës është punë ekspertësh dhe profesionistësh. Natyrisht është edhe çështje dashurie, ndershmërie dhe patriotizmi dhe kërkon njerëzit që i plotësojnë kushtet për këtë detyrë të shenjtë kombëtare.